



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE**

Nr. 292/6 Prot

Tiranë, më 29.03.2024

VENDIM

Nr. 06, datë 29.03.2024

PËR

SANKSIONIMIN E TITULLARIT TË AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularët e Ankesave me nr. 1613 prot., datë 04.10.2023, nr. 1663 prot., datë 12.10.2023, nr. 1665 prot., datë 12.10.2023, nr. 1666 prot., datë 12.10.2023, nr. 1667 prot., datë 12.10.2023 dhe nr. 1724 prot., datë 25.10.2023 me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Shoqëria Rajonale e Ujësjetës Kanalizime Dibër sh.a. (në vijim “Autoriteti Publik”).

Komisioneri, pas kryerjes së hetimit administrativ, ka dalë me vendim urdhërimi, për secilën nga ankesat e sipërcituara, përkatësisht me vendimet nr. 54, datë 07.12.2023, nr.55, datë 07.12.2023, nr. 56, datë 11.12.2023, nr. 57, datë 11.12.2023, nr. 58, datë 11.12.2023 dhe nr. 59, datë 11.12.2023. Nëpërmjet këtyre vendimeve, Zyra e Komisionerit, ka vendosur të urdhërojë Autoritetin Publik për të vënë në dispozicion të ankuesit dokumentacionin e kërkuar brenda datës 18.12.2023.

Në tejkallim të afatit të përcaktuar nga Komisioneri, për zbatimin e vendimeve të sipërcituara, ankuesi, me e-mail-in datë 26.01.2024, regjistruar me nr. 292 Prot., datë 29.01.2024, ka njoftuar se: “Autoriteti Publik ka respektuar vendimet me nr. 55 dhe 57 duke sjellë një informacion të “cunguar”, por që i konsideron të përmbushura.

Ndërkohë, vendimet me nr. 54, datë 07.12.2023, nr. 56, datë 11.12.2023, nr. 58, datë 11.12.2023 dhe nr. 59, datë 11.12.2023 kanë mbetur pa u zbatuar nga Autoriteti Publik. ” Në këto kushte, ankuesi, kërkon marrjen e masave përkatëse nga Komisioneri, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim, “LDI”).

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes bazuar në pikën 6/1 të nenit 24, të LDI, në të cilin parashikohet se: *“Autoriteti Publik është i detyruar të zbatojë vendimin e Komisionerit kur ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos pezullimin e zbatimit të tij”*, me shkresën nr. 292/1 Prot., datë 05.02.2024, kërkoi të informohet në lidhje me procedurën e ndjekur nga Autoriteti Publik pas vendimmarrjes së sipërcituar, brenda datës 12.02.2024.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 190/1 Prot., datë 12.02.2024, regjistruar me nr. 292/2 Prot., datë 14.02.2024, ka sqaruar Komisionerin se: *“...pas zhvillimit të seancës dëgjimore të mbajtur në zyrat e Komisionerit, është dorëzuar i gjithë informacioni i kërkuar në formën e një kthim përgjigje mbi çdo kërkesë lidhur me të drejtën e informimit të kërkuar nga ana e z. _____, dorëzuar në zyrat e Protokoll/Arkivës të këtij institucioni, duke zbatuar në këtë mënyrë dhe vendimin e Komisionerit”*.

Në vijim, pas verifikimit në zyrën e protokollit të informacionit/dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Autoriteti Publik rezultoi se, ky i fundit ka kthyer disa përgjigje të cilat janë regjistruar përkatësisht me nr. 1724/6 prot., datë 17.11.2023, nr.1666/7 prot., datë 15.12.2023 dhe nr. 1665/7 prot., datë 18.12.2023. Shkresa këto të cilat, edhe pse Autoriteti Publik ka pasur detyrimin për t’ja vendosur vetë në dispozicion palës ankuese, këtij të fundit, i’a ka bërë më dije Komisioneri menjëherë sapo kanë ardhur në institucion.

Megjithatë, Komisioneri nëpërmjet e-mail-it datë 22.02.2024, ka vendosur edhe njëherë në dispozicion të ankuesit të gjithë informacionin e përcjellë nga Autoriteti Publik duke kërkuar qëndrimin përkatës nëse informacioni i vendosur në dispozicion është apo jo në përputhje me vendimmarrjen e sipërcituar.

Ankuesi, me e-mail-in datë 22.02.2024, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 292/3 prot., datë 23.02.2024, sqaron se: *“... pas verifikimit me kujdes të informacionit të sjellë - skanuar nga Zyra e Komisionerit, pasi Autoriteti Publik nuk mund ta sillte në rrugë elektronike në këtë adresë, për të shmangur në këtë mënyrë edhe vonesat e panevojshme, jemi në vazhden e “merr shkresa e ngjit”, pa u bazuar aspak në vendimet përkatëse dhe në ato çfarë kërkohet.*

Nga këto shkresa, rezulton se është përmbushur vetëm vendimi me nr. 56, ku në një paragraf të shkresës së Autoritetit Publik me nr. 1189 prot., datë 16.11.2023 thuhet se nuk i disponojnë dokumentet e kërkuara. Ndërkohë, vazhdon të mos zbatohet vendimi numër 54, 58 dhe 59 i Komisionerit.”

Nisur nga këto fakte dhe deklarime të ankuesit, Komisioneri, me shkresën nr. 292/4 Prot., datë 04.03.2024, ka bërë me dije titullarin e Autoritetit Publik se: *“...ankuesi ka vijuar me ankimin e regjistruar me nr. 292/3 prot., datë 23.02.2024, me anë të të cilit pretendon se: “...pas verifikimit me kujdes të informacionit të sjellë - skanuar nga Zyra e Komisionerit... rezulton se është përmbushur vetëm vendimi me nr. 56, ku në një paragraf të shkresës së Autoritetit Publik me nr. 1189 prot., datë 16.11.2023 thuhet se nuk i disponojnë dokumentet e kërkuara. Ndërkohë, vazhdon të mos zbatohet vendimi numër 54, 58 dhe 59 i Komisionerit.”*

Në këto kushte, ka sjellë në vëmendje të tij se: *“Në cilësinë e titullarit të Autoritetit Publik, si dhe të personit përgjegjës bazuar në LDI, duhet të vendosë në dispozicion të Zyrës së Komisionerit, provat përkatëse nëpërmjet të cilave vërteton vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, në përputhje me vendimet nr.54, datë 07.12.2023, nr. 58, datë 11.12.2023 dhe nr. 59, datë 11.12.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda datës 11.03.2024.”*

Në vijim, titullari i Autoritetit Publik nuk ka kthyer asnjë përgjigje në lidhje me qëndrimin e kërkuar nga Komisioneri.

Për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion pas vendimeve përkatëse, si dhe qëndrimin të parashtruar nga ankuesi, Komisioneri konstaton se, Autoriteti Publik nuk arriti të provojë vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar. Rrjedhimisht, rezulton se Autoriteti Publik nuk ka zbatuar vendimet me nr. 54, datë 07.12.2023, nr. 58, datë 11.12.2023 dhe nr. 59, datë 11.12.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në kundërshtim kjo, me pikën 6/1 të nenit 24, të LDI, në të cilin parashikohet se: *“Autoriteti Publik është i detyruar të zbatojë vendimin e Komisionerit kur ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos pezullimin e zbatimit të tij”.*

Sa i përket përgjegjësisë për refuzimin e dhënies së informacionit, Komisioneri konstaton se personi që mban përgjegjësi për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar/moszbatimin e vendimeve, për këtë rast, është titullari i Autoritetit Publik.

Kjo bazuar në shkronjën “o” të pikës 2 të nenit 18, në të cilën parashikohet se: *“...“o” moszbatimi i vendimit të Komisionerit kur ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, sipas përcaktimeve të pikës 6/1 të nenit 24 të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë”* si dhe pikën 1 të nenit 19 ku citohet se: *“Titullari i autoritetit publik mban përgjegjësi ligjore-administrative për shkeljet administrative të parashikuara në shkronjat... “o” të pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji”.*

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën o) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 1 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjin nr. 10 279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Sanksionimin e z. Mario Bakalli, në cilësinë e personit përgjegjës si Titullar i Autoritetit Publik, për moszbatimin e vendimeve me nr. 54, datë 07.12.2023, nr. 58, datë 11.12.2023 dhe nr. 59, datë 11.12.2023 të Komisionerit, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me pikën 1 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 21 të ligjit të sipërcituar. Gjoha ekzekutohet nga Sektori i Financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit në përputhje me nenin 23 të ligjit të sipërcituar.
2. Kundër vendimmarrjes së Komisionerit, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 29.03.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi